

PËRKUJTIMORE

**Konferenca e VII-të Kombëtare e LPSH-së:
"Etika dhe Psikiatria". Prishtinë, 3-4 Qershor 2016.**

85 vjetori i lindjes së Prof. Dr. Ulvi Vehbiut, një nga personalitetet më të shquara të Psikiatrisë shqiptare

**Prof. Dr. Vuksan Kola, Fakulteti i Mjekësisë,
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
QSU "Nënë Tereza", Shërbimi i Psikiatrisë, Tiranë**

Abstrakt

Prof. Ulvi Vehbiu lindi në Gjirokastrë me 31 maj të vitit 1931. Mbas mbarimit të gjimnazit "Asim Zeneli" në Gjirokastrë me "Medalje ari" vazhdoi studimet e larta për mjekësi në Moskë, të cilat i mbaroi me "Diplomë të Shkëlqyer" në vitin 1956. Në përfundim të studimeve, zgjodhi të specializohej në fushën e vështirë të neuropsikiatrisë. I pajisur me njohuri të thella shkencore në një shtet të huaj kthehet menjëherë në Shqipëri dhe fillon punën si pedagog i lëndës së Psikiatrisë. E gjithë veprimtaria e tij profesionale, deri në fund të jetës, u vu në shërbim të zhvillimit të psikiatrisë tonë, duke dhënë një kontribut jashtëzakonisht të çmuar që e rendit atë në njërin nga personalitet më të shquar të saj. Ai punoi pa u lodhur dhe luajti rol vendimtar jo vetëm në krijimin e konsolidimin e Psikiatrisë klinike në Shqipëri, por edhe në përgatitjen e brezave të tërë mjekësh psikiatër, që do të vazhdojnë të ruajnë me dashuri e respekt kujtimin dhe trashëgiminë e tij të pasur.

Në 85 vjetorin e lindjes anëtarësia e LPSH-së e kujton me nderim të madh Prof. Ulvi Vehbiun, "Anëtarin e Nderit" të kësaj shoqate për dy vite me radhë, duke ruajtur të gjallë praninë e tij në presidiumet e konferencave tona kombëtare, ligjëratat elokuede dhe diskutimet shkencore që të ngjallnin kurdoherë interes, admirim e respekt.

85th birth anniversary of Prof. Dr. Ulvi Vehbiu, one of the most prominent personalities of the Albanian Psychiatry

**Prof. Dr. Vuksan Kola, Faculty of Medicine,
University of Medicine, Tirana
UHC "Mother Teresa", Psychiatry Service, Tirana**

Abstract

Prof. Ulvi Vehbiu was born in Gjirokastra on 31 May 1931. After finishing middle school "Asim Zeneli" in Gjirokastra with a gold medal, he continued his studies in medicine in Moscow, where he ended with "Excellent Graduate" in 1956. At the end of his studies, he chose to specialize in the difficult field of neuropsychiatry. Equipped with deep scientific knowledge in a foreign country he returned immediately to Albania and began working as a lecturer in the subject of Psychiatry. All his professional activity until late in life, served the development of our psychiatry, providing an extremely valuable contribution to order it in one of the most prominent personality of her. He worked tirelessly and played a crucial role not only in the creation and consolidation of Psychiatric clinic in Albania, but also in preparation for generations of psychiatrists, who will continue to maintain love and respect in the memory and legacy of his wealthy.

In his 85th anniversary of birth, the LPSH's membership remembers with great honor Prof. Ulvi Vehbi, "Honorary Member" of the association for two years, keeping alive his presence in our national conference presidium, eloquent lectures and scientific discussions to command whenever interest, admiration and respect.